



SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

Nr _____ Prot

Datë / /2024

PROCESVERBAL – sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti I Procedurës: “Printim faturash ”2024(sherbim)

Kodi Përkatës Në Fjalorin E Përbashkët Të Prokurimit (CPV): Printim faturash

Vlera E Fondit Limit: **1 461 705 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatqind e pesë)**lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKGJ sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Shenim: Operatori ekonomik fitues paraprkisht ,sebashku me dokumentacionin e dorezuar ne sistemin elektronik,duhet te paraqesi edhe dokumentacion e vetdeklaruar ne Formularin 8 ,origjinal ose te noteriazuar.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr. 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare ((2020,2021,2022),), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 gërma b) , të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **po pa tejkaluar vleren maksimale të përcaktuar në këtë procedure**, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015” Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” (ose ekuivalente) (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë.

- b) Certifikatën ISO 27001:2018 “Për sigurinë e informacionit” (ose ekuivalente) (e vlefshme).

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës duhet të disponojë në **pronësi ose me qera 2(dy) makineri printimi digjitale me ngjyra, me shpejtësi min 20.000 copë fatura A4 në ditë secila(shoqëruar me kartelën teknike).**

Në rastin e shpalljes fitues të operatorit ekonomik para lidhjes së kontratës ,Autoriteti Kontraktor për makineritë e mësipërme do të kërkojë nga Operatori fitues dokumentat e mëposhtëme:

- Kur janë në pronësi :faturë tatimore shitblerje ose deklaratë zhdoganimi ose cdo formë tjetër të ligjshme disponimi

- Kur janë me qera :Kontratë qeraje të noterizuar si dhe dokumentat e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose fotokopje e noterizuar)

2.3.4 Operatori ekonomik pjesmarrës ,për realizimin e kontratës duhet të ketë të gjitha masat mbrojtëse për mbrojtjen e fileve nga humbja ,vjedhja apo aksesit I pa autorizuar.

Ky kriter kupton transferimin e fileve nga vendi I prodhimit prane AK me sukses që do të thote shmangien e humbjes,vjedhjes apo aksesit të paautorizuar(hakerimi).

Pë rre vertetuar përmbushjen e këtij kriteri OE ofertues duhet të paraqesin një vetdeklarim nga Administratori I Shoqërisë ,tek I cili deklaron në përgjegjësinë e tij të plotë se disponon të gjitha masat mbrojtëse për mbrojtjen e fileve nga humbja,vjedhja apo aksesit I paautorizuar(hakerimi)

2.3.5-Operatori ekonomik duhet te dorezoje nje vetdeklarim nga Administratori I Shoqerise ku merr përsiper transportin mujor te faturave pranë SHRUKGJ te cilat dorëzohen pranë Drejtorisë Tregtare,sektori I shitjes me procesverbal bashkëngjitur .

2.3.6-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në të cilën deklaron se do të ketë system Softëare (sisteme operative dhe aplikacione) dhe Hardëare për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e fileve për print.Ky sistem duhet të jetë në ambjent të mbyllur dhe të dedikuar,vëzhguar me kamera .

2.3.7Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në të cilën deklaron se do të dorëzoje faturat të vendosura në zarf (Self Mailer) i cili do të bëhet në zyrat qëndrore te SHRUKGJ –së Brenda 24 H ,konkretisht te Drejtoria Tregtare ,sektori i shitjes me procesverbal bashkëngjitur

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

-Faturat do të jenë në forma A4 .Printimi i faturave do të jetë në dy anë.

Zarfimi i faturës do të bëhet në formën “selfmailer” me përforcim dhe do të paloset në formën “C”

-Letra e paraprintuar (logo kryesore në të dyja krahët e faturës si dhe imazh ose sfond(të jetë me ngjyra dhe të dhënat e tjera.

Imazhi i letrës mund të ndryshojë cdo 3 (tre) muaj.Të dhënat e tjera të faturës të jenë me ngjyrë të zeze.

-Fatura duhet të ketë dy linja përforcimi përgjatë gjatësisë së faturës për hapjen e zarfit si dhe instruksionet përkatëse për hapjen e zarfit.

Ngjitje nga krahët anësore. Përforcim horizontal të linjave të treguar.

Cdo faturë në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë numrin serial të lotit të fileve, zonën dhe numërorin për çdo zonë.

-Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) makineri dixhitale me ngjyra.

Disponimi i makinerive duhet të vërtetohet me fature blerje ose dokument zhdoganimi ose cdo formë tjetër të ligjshme disponimi.

-Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë printime dhe zarfime **selfmailer**.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

1-Bexhet Baxhella

2-Suada Guma

3-Arqile Puleri